



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 38

Prishtinë, më 12.12.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi.

Munguan : Liburn Aliu dhe Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 5.12.2011,**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit për OMGJ,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5.12.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 5.12.2011.

3. Shqyrtimi i projektligjit për OMGJ

Kryetari Nait Hasani konstatoi se ky komision dhe grupi punues (kryesues **Nijazi Idrizi**) kanë shqyrtuar në fazat e deritashme këtë projektligj duke angazhuar ekspertin Bajram Berisha i cili ka dhënë mendimin profesional me të cilin konstaton se projekti në fjalë nuk plotëson kriteret e duhura për të kaluar në shqyrtimin e dytë, ngase nuk është e kompletuar, përkatësisht ky projekt trajton OMGJ vetëm si ushqime bimore, ndërsa mungon trajtimi si ushqime me origjinë shtazore, si kultura bujqësore etj. **Nijazi Idrizi** u pajtua me këtë sqarim dhe shtoi se ekspertiza nuk ka nevojë të përmbajë disa çështje të detalizuara dhe kërkoi kthimin e projektligjit në Qeveri për ripunim. **Kryetari** tha se ekspertiza është me shkrim dhe do të bashkëngjitet shkresave, ndërkaq shkresa kryesore është ajo të cilin e dërgon ky komision për mbledhjen plenare.

Salih Morina sugjeroi të bisedoi kryetari me ministrin e bujqësisë rreth tërheqjes së projektit në mënyrë që mos të anashkalohet fjala e propozuesit të ligjit. **Kryetari** arsyetoi qëndrimin se komisioni duhet të veprojë për shkak të afateve ligjore, ndërkaq vërtetoi se me ministrin e bujqësisë ka biseduar gojarisht i cili është pajtuar rreth tërheqjes së projektit. Komisioni nxori këtë :

P Ë R F U N D I M

Miratohet raporti me rekomandimin i raportuesit Nijazi Idrizi.

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të mos miratohet në shqyrtimin e dytë Projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Kërkohet nga eksperti Bajram Berisha ti shtojë ekspertizës shpjegimin më të zgjeruar të mendimit të tij profesional, në ndërkohë rekomandimi procedohet sipas procedurës parlamentare.

4. Të ndryshme

Kryetari vazhdoi mbledhjen si vijon :

Projektligji për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore është shqyrtuar nga komisionet e përhershme, sqaroi kryetari, pasi që paraprakisht ky komision ka vendosur për 4 amendamente. **Kryetari i komisionit** ka marrë pjesë edhe në punën e komisionit për komunitete, ku është ftuar një ekspert i cili ka konstatuar mos shkeljen e drejtave për komunitetet me këtë projektligj dhe ka sugjeruar mbetjen e datës 24 mars 1999 (kryetari Nait Hasani ka argumentuar se duhet të hiqet data për shkak të barazisë së qytetarëve para ligjit), megjithatë në ekspertizën me shkrim ka përmirësuar projektligjin më tepër se sa është paraparë me Rregulloren të Kuvendit. **Afërdita Berisha** dhe **Salih Morina** konstatuan se në grupin parlamentar të LDK është angazhuar stafi që të përcjellë procedurën sipas këtij projektligji dhe pohuan se nuk cenohen drejtat e komuniteteve me këtë projektligj, çka është konstatuar edhe me rekomandimin e komisionit për komunitete. Duke u pajtuar me këtë, **Nait Hasani** tha se çdo ligj në Kuvend paraqet politikën e caktuar, ndaj kush nuk pajtohet mund të kundërshtojë dhe të sugjeroi në mbledhjet plenare. **Nijazi Idrizi** shprehu mosdyshimin në punën e kryer të deritanishme rreth këtij projektligji. **Xheladin Hoxha** shefi i seksionit për komisione, kërkoi falje dhe sqaroi që komisioni do të ishte mirë të deklarohet rreth ekspertizës së dërguar nga ana e komisionit për komunitete për çka u pajtua me kryetarin se ajo është bërë me vonesë si dhe amendamente konkrete nga ky komision nuk ka. **Kryetari Nait Hasani** falënderoi për këtë ndërhyrje dhe tha se në rekomandimin përfundimtar do të shënohet patjetër edhe ky konstatim i komisionit, njëherit në emër të Komisionit nxori :

P Ë R F U N D I M

Dërgohet për leximin e dytë rekomandimi përfundimtar i komisionit funksional rreth Projektligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, duke shtuar konstatimin se ky komision nuk ka miratuar rekomandimin e komisionit për komunitete sa i përket ekspertizës së bërë në atë komision.

Projektligji për Hoçën e Madhe

Kryetari **Nait Hasani** konstatoi se **Liburn Aliu**-kryesues për projektligjin e Hoçës mungon por komisioni duhet të vendos shumë shpejt lidhur me angazhimin e një eksperti apo dy ekspertëve (një ligjor dhe tjetri për trashëgimi kulturore) rreth këtij projektligji ngase obligimi rrjedhë edhe nga Rezoluta e Parlamentit Evropian ku kërkohet urgjencë për këtë Projektligj dhe Projektligjin për Prizrenin (i cili ende nuk ka hy në leximin e parë). **Salih Morina** u pajtua se duhen dy ekspertë të angazhohen (edhe të jashtëm nëse ka nevojë) ashtu si u cek nga kryetari për shkak të mospajtimeve të ndryshme që do të mund të shfaqen në procedurën e mëtejme.

Kryetari Nait Hasani angazhoi koordinatorin të njoftoi Liburn Aliun i cili duhet të veproji si kryesues i GP rreth angazhimit të dy ekspertëve dhe të sugjeroi në komision emrat e tyre.

Iniciativa e një Shoqate të verëtarëve nga Rahoveci dhe rekomandimi i Komisionit për Buxhet rreth projektligjit për Agjencinë e Rrezatimeve

Kryetari në vazhdim njoftoi për iniciativën e shoqatës verëtare nga Rahoveci të cilët kanë kërkuar takimin me ministrin Blerand Stavilecin dhe ministrin Bedri Hamzën rreth shqyrtimit të sërishëm të iniciativës së tyre për të hequr akcizën për verëra. **Afërdita Berisha** sqaroi se është mirë të jetë prezent edhe Ministri i Financave ai vet të arsyetoj heqjen apo mos heqjen e akcizës para prodhuesve të verës. Ministri e ka prezantuar para komisionit se do të gjinden forma për subvencionim pa e hequr akcizën sepse buxhetit heqja e akcizës i shkakton humbje. Ajo tha se është në favor të prodhuesve Kosovar gjithmonë duke gjetur mënyrën me të mirë për përkrahjen e tyre dhe krijimin e kushteve për të bërë biznes sa me të suksesshëm. Edhe **Nait Hasani** insistoi se duhet të hiqen dilemat e fermerëve të asaj ane, ndaj sugjeroi që deri në mbledhjen e radhës të zhvillohen bisedimet me dy ministra për këtë çështje, pastaj të caktohet mbledhja e radhës ku do të ftohen ministrat për të shqyrtuar këtë çështje si dhe rekomandimin e komisionit për buxhet rreth implikimeve financiare për projektligjin e agjencisë për rrezatime dhe siguri nukleare.

Lidhur me rekomandimin e komisionit për buxhet rreth projektligjit për agjencinë e rrezatimeve Kryetari **Nait Hasani** në pajtim me komisionin, angazhoi konsulentin ligjor **Elton Tota** që deri në mbledhjen e radhës të hartoi rekomandimin lidhur me kërkesën e komisionit për buxhet për këtë projektligj, ngase në këtë komision kërkohet që agjencia të hyj në kuadër të MMPH e jo të qëndroi ashtu si është propozuar në projekt, ngase implikimet buxhetore janë më të mëdha nëse mbetet si është tani në këtë projektligj.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-098 për bujqësinë dhe zhvillimin rural

Lidhur me shqyrtimin në parim të këtij projektligji, komisioni nxori :

R e k o m a n d i m **për mbledhjen plenare**

1. Të miratohet në parim, Projektligji për ndryshim e plotësim të ligjit 03/L-098 për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 11,40.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani